



Aktivitetet e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike

15.07.2009

Deri më 7 korrik, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike, konform nenit 15.3 dhe 15.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Zgjedhjet Lokale, ka pranuar aplikimet e partive politike që marrin pjesë në zgjedhjet e 15 Nëntorit. Nga të gjitha partitë politike të regjistruara, Partia Nacionale Demokratike Shqiptare (PNDSh), ka njoftuar Zyrën që nuk garon në zgjedhje. Ndërsa, ka aplikuar një koalicion. Ky është koalicioni Vakaf, i përbërë nga DSB, DSV dhe NBS. Gjithashtu, është edhe një koalicion për kryetar komune në Prizreni, i lidhur në mes të LDD, BSDAK dhe BK.

Aplikimet e partive politike:

- 19 Parti Politike Shqiptare
- 6 Parti politike Serbe
- 7 Parti Politike Boshnjake
- 1 Parti Politike Turke
- 1 Parti Politike Gorane
- 1 Parti Politike Rome
- 1 Parti Politike Egjiptiane
- 2 Parti Politike të Ashkalive
- 1 Parti Politike Malaziase
- 1 Kandidat i pavarur për Kryetar Komune në Obiliq